



Ministria e Punëve
të Jashtme dhe Diasporës



Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës



Biblioteka Kombëtare
e Kosovës
"Pjetër Bogdani"



1953
Instituti Albanologjik



Instituti i Historisë
Ali Hadri-Prishtinë

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVO			
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTMË DHE DIASPORËS MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS AND DIASPORA AFFAIRS AND INSTITUTE FOR STRATEGIC POLICY AND DIASPORA DIVISION FOR ADMINISTRATION OF DOCUMENTS AND ARCHIVES MANAGEMENT AND INFORMATION TECHNOLOGY DIVISION FOR ADMINISTRATIVE DOCUMENTS ARCHIVING			
Njësia Org Org. Jedri Org. Uini	15.1	Nr Prot Br Prot Prot No	4956
Nr. Fajevë Br. Stranica No. Pages	04	Dati Datum Date	31.10.23
Prishtinë / a			

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS
AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË KOSOVËS
INSTITUTIT ALBANOLOGJIK
DHE
INSTITUTIT TË HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË

Prishtinë, tetor 2023

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Instituti Albanologjik dhe Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, më poshtë të quajtura si “palët”. Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e objektivave të përbashkëta kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi për dhurimin e botimeve për institucionet përkatëse për këndin e librave në ambasadat, konsullatat, zyrat diplomatike, si dhe katedrave albanologjike jashtë vendit.

1. Qëllimi i memorandumit të Bashkëpunimit

Qëllimi i këtij Memorandumi është ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor dhe arsimor të diasporës, njohja e qytetarëve të huaj me kulturën, literaturën dhe historinë e Kosovës, si dhe lidhshmëria e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Ky Memorandum parashih krijimin e këndit të librave të dhuruara për ambasadat, konsullatat, zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrat albanologjike në universitetet përkatëse jashtë vendit që do të ndikonte në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe shtetëror të Kosovës.

2. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Obligimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (më tutje MPJD)

- 2.1 Në bashkëpunim me ASHAK, BKK, IA, IHP siguron fonde të botimeve të dhuruara nga palët përkatëse për ambasadat, konsullatat, zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrat albanologjike në universitetet jashtë vendit;
- 2.2 Në bashkëpunim me palët, koordinohen për përgatitjen e fondit të botimeve për ambasadat, konsullatat dhe zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrat albanologjike në universitetet jashtë vendit;
- 2.3 Shpërndan fondet e botimeve të siguruar nga palët, për ambasadat, konsullatat dhe zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrat albanologjike në universitetet jashtë vendit;
- 2.4 MPJD, të gjitha aktivitetet në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do t'i promovojë si aktivitete të përbashkëta me palët.

3. Obligimet e Palëve

Palët marrin përsipër obligime që i përkasin qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, si në vijim:

- 3.1. Identifikojnë dhe përzgjedhin tituj nga fondet e tyre sipas kërkesës së MPJD-së për institucionet përkatëse;
- 3.2. Kontribuojnë për zhvillimin e koleksioneve për ambasadat, konsullatat dhe zyrat diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrat albanologjike në universitetet jashtë vendit;
- 3.3. Grumbullojnë dhe dorëzojnë fondin e botimeve për MPJD, dedikuar ambasadave, konsullatave, zyrave diplomatike të Republikës së Kosovës, si dhe katedrave albanologjike;
- 3.4. Palët, të gjitha aktivitetet në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do t'i promovojnë si aktivitete të përbashkëta me MPJD-në.

4. Zbatimi

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në bashkëpunim me Palët përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e saj.

5. Afati i realizimit

Afati i realizimi të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda 4 (katër) viteve. Memorandumit i Bashkëpunimit vazhdohet me automatizëm nëse palët nënshkruese nuk kërkojnë ndërprerjen e tij në afatin e paraparë.

6. Amandamenti

Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshohet apo të plotësohet sipas një marrëveshjeje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB, të nënshkruar nga palët e këtij Memorandumi, do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

7. Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime të përbashkëta.

8. Kopjet dhe gjuhët e memorandumit të bashkëpunimit

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.


9. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi më datën e nënshkrimit nga palët.


Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës


z. Behar Isma, zv. Sekretar i Përgjithshëm i
Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës


Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës


znj. Lendita Pula, Sekretare e Akademisë
së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës


Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"


z. Fazli Gajraku, Drejtor në
Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"

Instituti Albanologjik


Prof. dr. z. Hysen Matoshi, Drejtor në Institutin
Albanologjik të Kosovës

Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë


Prof. Dr. znj. Teuta Shala-Peli
Drejtoreshë e Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë